REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 896 Prot. Vlorë, më 17/03/2022

Lënda : *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore).*

PREFEKTIT TË QARKUT - FIER

Duke vlerësuar me kënaqësi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, në bashkërendimin e veprimeve për zgjidhjen e problemeve të dyanëshme, si dhe me synimin e përmbushjes së misioneve tona të ngarkuara nga Ligji, e shohim të domosdoshëm forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, pasi nga ana jonë konstatohet se në shume raste nëpërmjet Tij, është mundësuar shlyerja e borxhit doganor.

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", neni 48/4 i Tij "Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve" - "*Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre*", në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile", neni 131 i Tij "*Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale....*", nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" - "*Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet*", si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", pika VI.3.b e Tij, "*Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të*

bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe.në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar ... ...". kërkojmë nga ana Juaj : "**Shpalljen Publike"** për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të një akti administrativ – Vendimi për kontabilizimin e detyrimeve doganore (bashkëngjitur), si vijon :

• Nr.23, me Nr.248/2 Prot., datë 09/10/2022, i materializuar për subjektin "**Aziz Alush Azizi**" p.f, me banim në Fier (Rruga "Ramiz Aranitasi", Ndërtesa nr.59, Hyrja 10, Apartamenti 5).

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE FIER
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.248/2 Prot. Vlorë, më 09/02/2022

VENDIM NR.23

Sot, më datë 09/02/2022, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi mora në shqyrtim shkresën Nr.248/1 Prot., datë 28/01/2022 me lëndë "Procesverbal", i mbajtur nga specialisti i kontrollit aposterior pranë Degës së Doganës Vlorë, për deklaratën doganore IM.4 me R 10983, datë 14-08-2021), ndaj subjektit "Aziz Azizi" p.f, me ID. G80529050C, me banim në Fier (Rruga "Ramiz Aranitasi", Ndërtesa nr.59, Hyrja 10, Apartamenti 5),

KONSTATOVA SE:

Më datën 14/08/2021, pranë Degës së Doganës Vlorë, është paraqitur subjekti "Aziz Azizi" p.f, me ID. G80529050C, me banim në Vlorë, i përfaqësuar nga Agjensia Doganore "Egnatia Customs Agency - Shpk" me kod J 112, për të deklaruar vendosjen në qarkullim të lirë të mallit të Tij, me deklaratën doganore IMP - 4 me numër R 10983.

Me deklaratën doganore të lartpërmendur, nga ana e subjektit është deklaruar artikulli "Motorr i përdorur entrobordo - AIFO, vitprodhimi 1981, Model 8361 SM, pesha neto 1,700 kg, i deklaruar në kodin tarifor 8407 2199. Bashkëngjitur deklaratës doganore ndodhej dokumentacioni doganor përkatës.

Në zbatim të legjislacionit doganor, nga ana e Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit, është dërguar shkresa nr.21910 Prot., datë 07/12/2021, me lëndë "Mbi problematikat e vlerësimit doganor", e administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë me nr.248 Prot., datë 24/01/2022.

Sipas kësaj shkrese rezulton se nga ana e Sektorit të Mbikqyrjes së Vlerës Doganore në Drejtorinë e Politikave të Vlerësimit Doganor, gjatë monitorimit të deklarimeve doganore për muajin Nëntor 2021, janë evidentuar disa praktika doganore të cilat mendohet se duhen rishikuar, për arsye të vlerësimit doganor.

Midis të tjerave, në këtë shkresë, është kërkuar rishikimi i vlerësimit doganor për mallin e deklaruar, me anë të deklaratës doganore IMP.4 me R 10983, datë 14/08/2021, për artikullin "Motorr i përdorur

entrobordo - AIFO, vitprodhimi 1981, Model 8361 SM", i deklaruar në kodin tarifor *8407*, me vlerë të deklauar 1,000 euro dhe me peshë neto 1.700 kg.

Në zbatim të shkresë të lartpërmendur, përfaqësuesit ligjor të subjektit i është bërë e ditur kontrolli aposterior ndaj deklaratës doganore, si dhe i dërguar formulari mbi vlerësimin doganor i datës 28.01.2022, i cili është nënshkruar pa rezerva prej tij.

Më tej, specialisti i kontrollit aposterior pranë Degës së Doganës Vlorë, ka proceduar me rivlerësimin (kontrollin aposterior) të deklaratës doganore IMP.4 me R 10983, datë 14/08/2021, ku në përfundim, bazuar edhe në praktikat analoge, ka mbajtur shkresën Nr.248/1 Prot., datë 28/01/2022 me lëndë "Procesverbal", në të cilin ka parashtruar si vijon : "Në zbatim të neneve 66-70 të Ligjit nr.102/2014 dt 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.3, dt.23.01.2018 "Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore", u kryen verifikimet në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës doganore dhe rezulton se nuk ka përmbushur kërkesat për të vërtetuar transaksionin dhe as vlerësimin e bërë nga sektori DVQ në D.P.D, duke e vlerësuar me çmimin prej 1.13 euro/kg. Zyra e kontrollit aposterior doli në përfundim se në mungesë të vlerës referuese në Dosjen e të Dhënave të Disponueshme, artikulli do të vlerësohet me metodën 3 të vlerësimit doganor në të njëjtën periudhë që janë vlerësuar mallra të ngjashëm me praktikën tonë duke marrë si referim praktikën IM.4 R 10980 datë 14/08/2021 duke e vlerësuar me çmimin 1.8euro/kg. U hartua formulari i rivlerësimit i cili u firmos nga agjensia doganore e përfaqësimit të subjektit në doganë duke i atakuar një detyrim shtesë prej 27,518 (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

Në zbatim të neneve 66 -70 të Ligjit nr. 102/2014 dt. 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), si dhe pikës 17.1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 3, dt.23.01.2018 "Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore", u kryen verifikimet në dokumentacionin bashkëngjitur praktikës doganore dhe rezulton se : Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion shtesë për të vërtetuar transaksionin e kryer si p.sh pagesë të plotë bankare për shlyerjen e faturës tregtare etj. Në këto kushte, nga shqyrtimi i fakteve të lartëpërmendura si dhe nga verifikimi i vlerave të deklaruara në Database Kombëtare të Vlerësimit, konstatohet se nuk plotësohen kushtet e pikës 7 dhe pikës 8 të Udhëzimit nr. 3 dt.23.01.2018 të MFE, prandaj dakortësohemi me rivlerësimin doganor të pasqyruar në "Proces verbalin e kontrollit aposterior" për deklaratën doganore R 10983, dt. 14.08.2021 të hartuar nga Specialisti i Kontrollit Aposterior Vlore, vlera per qellime doganore do të meret 1.8 Euro/Kg.

Për sa më lart, mbështetur në kreun III "Vlera për qëllime doganore" neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 "Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore" të Ministrit të Financave, VKM nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor",

V E N D O S A :

• Subjekti "Aziz Azizi" p.f, me ID. G80529050C, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **27.518** (Njëzeteshtatëmijë e pesëqindetetëmbëdhjetë) lekë, për deklaratën doganore IM. 4 me numër R 10983, datë 14/08/2021.

• Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.

• Specialisti i Kontrollit aposterior të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.

• Kundër këtij vendimi, subjekti "Aziz Azizi" p.f, me ID. G80529050C, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*".

K R Y E T A R

Artan Beliraj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE - VLORË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË